



|  |          |
|--|----------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIK E KOSOVO   |          |
| MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS<br>MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE<br>MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE |          |
| Njësia org.<br>Org.Jedinita<br>Org.Unit  | 01       |
| Nr. i Faqeve<br>Bc. Stranica<br>No.Pages   | 1        |
| Nr. i Prot.<br>Broj Prot.<br>Prot. No.   | 9835     |
| Data:<br>Datum:<br>Date:   | 28.12.23 |
| PRISHTINË / A  |          |
| No.2   |          |

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit ,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Zivotne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment , Spatial Planning and Infrastructure

Zv.Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar ne dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 8 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 14/2023 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë

## VENDIM

**I. Refuzohet**, kërkesa nr.8856 date 17.11.2023 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus A.T.“EDI TOURS” me seli në Pejë për marrjen e nisjes në relacionin Pejë-Prishtinë me orare të nisjes (10:20 - 12:40).

### *Arsyetim*

Pas shqyrtimit të aplikacionit dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus A.T.“EDI TOURS” me seli në Pejë, nuk ka plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndërurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për

për e nisjes ne relacionin Pejë-Prishtinë me orare te nisjes (10:20 - 12:40), respektivisht kjo nisje nuk ekziston ne kuader te shpalljes publike te nisjeve te lira ne relacionin respektiv.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtojë ankesë në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

**Hysen Dürmishi**

Zv.Ministër



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.